

**GJYKATA THEMELORE-Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë**, në përbërje të Gjyqtarit Gëzim Pozhegu - Kryetari i trupit gjykues, gjyqtarëve Diana Sina dhe Shaqir Zika– anëtar të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Arbënore Basha, në çështjen penale kundër të akuzuarve M. H. nga fshati K., Komuna e Dragashit, Sh. A. nga fshati P., Komuna e Suharekës dhe të akuzuarit E. F. nga fshati P., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale: shpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 339 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, të akuzuar nga Prokuroria Themelore-Departamenti për Krime të rënda në Gjakovë, PP/I.nr.02/2015 të datës 06.02.2015, në praninë e Prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore– Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë Agron Matjani, të akuzuarve M. H., Sh. A. dhe E. F., në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 01.08.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **Kundër të akuzuarve :**

**M. H.**, i biri i S. dhe nënës I., e gjinisë Q., i lindur me..., në fsh. K., Komuna e Dragashit, tani me banim në Prizren, ka të kryer Fakultetin e Bujqësisë-Drejtimi i përgjithshëm, i punësuar në Agjensionin për Zhvillimin e Bujqësisë, i martuar, baba i 4 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar- shtetas i Republikës së Kosovës, i padënuar më parë.

**SH. A.**, i biri i S. dhe nënës H., e gjinisë Sh., i lindur me ..., në fsh. P. Komuna e Suharekës, tani me banim në Suharekë, ka të kryer Fakultetin e Bujqësisë, i punësuar në Agjensionin për Zhvillimin e Bujqësisë, i martuar, baba i 2 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar– shtetas i Republikës së Kosovës, i padënuar më parë.

**E. F.**, i biri i B. dhe nënës I., e gjinisë K., i lindur me ..., në fsh. P. Komuna e Suharekës, ku dhe tani banon, ka të kryer Fakultetin e Bujqësisë, i punësuar në Agjensionin për Zhvillimin e Bujqësisë Zyra Regjionale në Prizren, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar– shtetas i Republikës së Kosovës, i padënuar më parë.

**Konform në nenin 363 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së:**

## **REFUZOHET AKUZA**

Se më datë 21.12.2012 në Rahovec tek shtëpia e të dëmtuarit J. Z. nga Rahoveci, në cilësinë e personave zyrtarë gjatë inspektimit dhe kontrollit tek shtëpia e fermerit këtu i dëmtuari J. nuk e përmbushin detyrën zyrtare në atë mënyrë që pasi shkojnë tek shtëpia e të dëmtuarit për verifikimin dhe kontrollimin e kafshëve të imta (deleve), komunikojnë me vëllain e të dëmtuarit F. Z. dhe i cili tregon se ferma e deleve është aty afër shtëpisë së

fermerit, me ç'rast këtu të akuzuarit fare nuk shkojnë dhe të bëjnë kontrollin e deleve, por vetëm e kërkojnë që të vihet nënshkrimi i vëllait të fermerit dhe më pas, largohen nga shtëpia duke mos shkuar fare tek ferma për kontrollimin e matrikulave tek delet, kështu që rezultoi me pasojë si humbjen e subvencioneve për pagesa direkt tek Ministria e Bujqësisë dhe atë për 3 vite me radhë duke i shkaktuar dëme në shumën prej 3.540 €.

- **me çka kishin për të kryer veprën penale: shpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 339 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së.**

#### **Për shkak të tërheqjes së prokurorit nga ndjekja penale.**

Në kuptim të nenit 454 par.1 të KPPK-së shpenzimet e procedurës penale bien mbi barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Në kuptim të nenit 463 par.2 të KPPK-së, i dëmtuari për kërkesën pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore-Departamenti për Krime të Rënda Gjakovë, ka ngritur akuzën PP/I.nr.02/2015 të datës 06.02.2015, kundër të akuzuarve M. H. nga fshati K. Komuna e Dragashit, Sh. A. nga fshati P. Komuna e Suharekës dhe të akuzuarit E. F. nga fshati P. Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale: shpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 339 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Pas leximit të aktakuzës në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 01.08.2016, gjykata e bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën, të akuzuarve iu është dhënë mundësia që të deklarohen lidhur me pranimin ose mospranimin e fajësisë, ku të akuzuarit deklarohen të pafajshëm.

Gjatë shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.01.08.2016, Prokurori i shtetit Agron Matjani në fjalën përfundimtare deklaroi se: Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor verbal- publik dhe pas administrimit të të gjitha provave nga aktakuza, dëshmisë së të akuzuarve M. H. Sh. A. dhe E. F., nga dëgjimi i të dëmtuarit J. Z. dhe dëshmitarëve F. Z., Q. M. dhe pas administrimit të provave, u vërtetua se të akuzuarit në cilësinë e personave zyrtar pranë Ministrisë së Bujqësisë, Zyrës Regjionale në Prizren, si Inspektor kanë shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit J. Z., mirëpo i njëjti nuk ka qenë prezentë dhe ka deklaruar se i ka marrë subvencionet për vitin 2012 dhe ka autorizuar vëllain e tij F. Z. për të nënshkruar procesverbalin, të cilën gjë e ka bërë edhe pse i njëjti e ka ngatërruar marrjen e subvencioneve dhe përkundër këtij fakti ai ka pasur të drejtë të ankohet Zyrës regjionale në Prizren që vepron sipas Ministrisë së Bujqësisë, ka pas të drejtë të ankohet në Ministrinë e Bujqësisë, si dhe të iniciojë kontestin administrativë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti Administrativ, andaj duke u nisur nga rrethanat se nuk u arrit në mënyrë bindëse që të vërtetohet fajësia e të akuzuarve.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 01.08.2016, Prokurori i shtetit ka deklaruar se hekë dorë nga aktakuza ndaj të akuzuarve.

Pasi që në seancën publike të shqyrtimit kryesor Prokurori i Shtetit para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor është tërhequr nga aktakuza dhe për këtë kjo gjykatë konform nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPK-së, ka miratuar aktgjykimin dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse është miratuar aktgjykim refuzues dhe është vendosur që shpenzimet në këtë shqyrtim gjyqësor të bien në barrë të buxhetit të kësaj gjykate, kurse i dëmtuari është udhëzuar që kërkesën pasurore-juridike mund ta realizojë në kontest civil.

**GJYKATA THEMELORE–Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë,  
PKR.nr. 26/15, datë 01.08.2016.**

**Sekretarja juridike,**

**Arbënore Basha**

**Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari,**

**Gëzim Pozhegu**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit, e nëpërmjet kësaj Gjykate.